

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire des
Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

NGA PRITJA SOLEMNE
TË ISH SEKRETARES SË SHTETIT TË SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS MEDELEINE ALBRIGHT MË
5 KORRIK 2005

SA SVEĆANOG DOČEGA
BIVŠEG AMERIČKOG DRŽAVNOG SEKRETARA
MEDELEINE ALBRIGHT, PRILIKOM POSETE KOSOVA
DANA 05 JULA 2005. GODINE

Korrik – Juli
2005

T R A N S K R I P T

NGA PRITJA SOLEMNE TË ISH SEKRETARES SË SHTETIT TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS MEDELEINE ALBRIGHT MË 5 KORRIK 2005

Pritja u organizua në Sallën solemne të Kuvendit të Kosovës, në orën 11,00.

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS NEXHAT DACI:

Mirëmëngjesi. Mirëseardhje në Seancën solemne të Parlamentit të Kosovës që i dedikohet një nga personalitetet më të rëndësishme të historisë së re në memorie të popullit të Kosovës – për nderë të zonjës Albright që sot me ne.

Prandaj, më lejoni t'ju drejtohem.

E nderuara madam Medeleine Albright, i nderuari Prezident i Kosovës zoti Ibrahim Rugova,

I nderuari Kryeministër zoti Bajram Kosumi,

I nderuari Zëvendëskryeadministrator i Kosovës zoti Rosin,

Mirëseardhje korit apo zyrove diplomatike në Kosovë,

Mirëseardhje parisë së Komunës ose Qytetit të Prishtinës dhe të gjithë ministrave tjerë – të pranishëm.

Sot të gjithë ne jemi të nderuar që këtu – në Kuvendin e Kosovës, në organin më të lartë përfaqësues të popullit të Kosovës – të kemi në mesin tonë dhe ta dëgjojmë fjalën e zonjës Medeleine Albright ish Sekretares së Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në kohën kur Kosova përballej me ditët më të vështira në historinë e saj; kur rrezikohej qenia kombëtare biologjike e popullit të saj; kur bota kërcnohej me gjenocid në fund të shekullit njëzet në këtë pjesë të saj.

Të nderuar deputetë,

Sot, në Kosovën e lirë, të gjithë ne – pa dallim – jetojmë, punojmë, shkollohemi, zhvillojmë kulturën dhe kryejmë të gjitha punët dhe veprimtaritë tjera të përditshmërisë sonë si në çdo vend tjetër normal, pikërisht duke iu falënderuar politikës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, politikës së vendeve të Bashkimit Evropian, veprimet të NATO-s që për të parën herë në historinë e njerëzimit bashkuan të gjithë botën rreth qëllimit më fisnik të ndalin katastrofën humanitare, të ndalin gjenocidin dhe të kthejnë në shtëpitë e veta 1.000.000 qytetarë të Kosovës të përzënë me dhunë.

Në gjithë këtë, merita e zonjës Albright është shumë e madhe. Në disa momente, e pakrahasueshme në gjithë spektrin e saj dhe shumë konkret siç ishte rasti në Konferencën e Rambujesë, në mënyrë që ëndrra e Kosovës, ëndrra e gjithë popullit të saj për të jetuar i lirë, i denjëtetshëm dhe në paqe me të gjithë të tjerët të bëhet realitet.

Kjo ëndërr as që mund të mendohej pa angazhimin e gjithë popullit të Kosovës, pa vullnetin dhe përpjekjet e tij...